

AKT-THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë “**Elka S.A**” SHPK, sot në datën 11.01.2001, me ortak të vetëm: LEFTER KALLO, i biri i Kostës, i lindur më 1954, në Gjirokastër dhe banues po aty, në Vrisera.

NENI 1

Personi fizik i sipërpërmendur me vullnetin e tij të lirë dhe në pajtim me legjislacionin shqiptar, ra dakort që të krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK) me emërtimin “**Elka S.A**” SHPK”.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000. lekë

Kjo shoqëri e ka qendrën në Gjirokastër, në adresën që vijon: Vrisera, Gjirokastër.

Ortak i vetëm i saj dhe pronar i pasurisë është z. Lester Kallo.

Administrator i kësaj shoqërie është z. Lester Kallo.

Shoqëria “**Elka S.A**” SHPK ka të drejtë të krijojë filialet e saj brenda dhe jashtë vendit, në çdo kohë që të çmohet e arsyeshme prej saj dhe me miratim të organeve kompetente.

NENI 2

Shoqëria “**Elka S.A**” SHPK, gëzon *statusin* e personit juridik.

Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të këtij Akti, Statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi. Statuti i shoqërisë i bashkëngjitet Aktit të Themelimit dhe është pjesë përbërëse e tij.

NENI 3

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me miratimin e krijimit të saj nga organi kompetent shtetëror dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe të pakufizuar, mbi 10 vjet.

Shoqëria e mbaron aktivitetin kur për këtë marrin vendim unanim të gjithë ortakët që bëjnë pjesë në këtë shoqëri.

NENI 4

Shoqëria ka objekt të veprimitarës : “**Tregti e përgjithshme, me shumicë dhe me pakicë, import-eksporti i mallrave ushqimore, industriale, elektrike dhe elektroshtëpiake, i konfekSIONEVE dHE I PRODHIMEVE bujqësore e blegtorale, i pajisjeve dHE I PJESEVE TË KËMBIMIT pëR automjete; Prodhimi i të gjitha llojeve të uthullës së limonit, çokokremi, patatinave si dHE PRODHIMEVE TË tjera ushqimore e ndihmëse; ushtrimi i çdo lloj aktiviteti tregtar apo industrial që ka lidhje me prodhimin, blerjen, shitjen, importin, eksportin dHE FURNIZIMIN ME ARTIKUJT E MËSIPËRM**”. Ajo mund të kryejë edhe çdo veprimitari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt me sa më sipër.

NENI 5

Kapitali i saj themelor është 100.000 lekë i cili depozitohet i gjithë nga Ortaku i vetëm.

NENI 6

Për detyrimet që do të krijohen gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie ndaj personave të tretë, shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj. Ortaku i shoqërisë nuk mban

përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tij, që nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

NENI 7

Marrëdhëni e punës në shoqëri ose në filialat e saj, rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

NENI 8

Dispozita më të hollësishme për organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

Ortaku i Vetëm

LEFTER KALLO

Kall^y

**STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Elka S.A” SHPK**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**



NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Elka S.A” SHPK, themelohet në përputhje me ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”.

Kjo shoqëri krijuhet nga ortaku i vetëm: LEFTER KALLO, i biri i Kostës, i lindur më 1954, në Gjirokastër dhe banues po aty, në Vrisera.

Shoqëria e ka selinë e saj në Vrisera, Gjirokastër dhe do të njihet me emrin “Elka S.A” SHPK.

Kjo shoqëri ka të drejtë të çelë filiale, degë e përfaqësi në qytete të tjera të Shqipërisë e jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe atë të vendeve të tjera ku ato do të hapen.

Drejtues administrativ i kësaj shoqërie është z.Lefter Kallo.

NENI 2

Shoqëria “Elka S.A” SHPK e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e parashikuara në dokumentet e krijuimit të saj (Aktit të Themelimit dhe këtij Statuti).

Shoqëria “Elka S.A” SHPK, është person juridik. Ajo e fiton të drejtën e personit juridik nga data e regjistrimit në Gjykatë.

NENI 3

Shoqëria “Elka S.A” SHPK, krijuhet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një kohëzgjatje të pakufizuar, mbi 10 vjet.

Kjo shoqëri mund të zgjatë afatin e veprimtarisë së saj ose mund ta mbylli aktivitetin e saj, sipas dispozitave dhe kritereve që përcaktohen në Aktin e Themelimit e në Statut dhe, sipas kritereve që përcaktohen nga legjislacioni në fuqi.

NENI 4

Shoqëria “Elka S.A” SHPK, për detyrimet që do të lindin gjatë aktivitetit të saj me të tretët, përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ortaku nuk mban përgjegjësi për detyrimet e shoqërisë me pasurinë e tij, e cila nuk bën pjesë në kapitalin e kësaj shoqërie.

Pjesëmarrja në këtë shoqëri nuk e pengon ortakun të ketë pavarësi ligjore, organizative dhe të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.

NENI 5

Shoqëria “Elka S.A” SHPK, ka objekt të veprimtarisë së saj: “Tregti e përgjithshme, me shumicë dhe me pakicë, import-eksporti i mallrave ushqimore, industriale, elektrike dhe elektroshëpiake, i konfekSIONeve dhe i prodhimeve bujqësore e blegtorale, i pajisjeve dhe i pjesëve të këmbimit për automjete; Prodhimi i të gjitha llojeve të uthullës së limonit, çokokremit, patatinave si dhe prodhimeve të tjera ushqimore e ndihmëse; ushtrimi i çdo lloj aktiviteti tregtar apo industrial që ka lidhje me prodhimin, blerjen, shitjen, importin, eksportin dhe furnizimin me artikujt e mësipërm”. Ajo mund të kryejë edhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt me sa më sipër”.

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj, në përputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarisë së saj.

Shoqëria mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale, përfshirë të drejtën për të ofruar pasuritë e saj dhe për të marrë kredi bankare.

KREU II **MARRËDHËNIET EKONOMIKO-FINANCIARE**

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë "Elka S.A" SH.P.K, përbëhet në të holla në një vlerë prej 100.000 lekë.

Ky kapital themelor zotërohet nga ortaku i vetëm Lester Kallo në masën 100%. Kapitali themeltar ose pjesë të caktuara të tij janë të transferueshme përkundrejt personave të tretë.

NENI 7

Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij mbahen në një regjistër të veçantë.

NENI 8

Veprimitaria e shoqërisë realizohet në bazë të përfitimit ekonomik dhe pasqyrohet në bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit të shoqërisë duhet të përfundojë brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Bilanci i aktivitetit finanziar mund të bëhet nga vetë ortaku ose ekspertët e caktuar prej tij. Por, në të gjitha rastet, rezultatet e bilancit finanziar duhet t'i bëhen të njoitura ortakut.

NENI 9

Shoqëria krijon fondet e veta për zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të saj, në përputhje me rregullat në fuqi.

Përbërja e fondeve, burimet financiare të tyre, caktohen nga Asambleja e Ortakëve.

NENI 10

Shoqëria disponon plotësisht mjetet e saj financiare.

KREU III **TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE**

NENI 11

Ortaku ka të drejta kryesore të cilat ushtronen nëpërmjet vendimeve të marra prej tij:

-Të marrë pjesë në administrimin e veprimitarive prodhuese, ekonomiko-tregtare të shoqërisë, në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin.

-Të kërkojë dhe t'i jepen të dhëna që kanë të bëjnë me gjendjen dhe veprimitarinë e shoqërisë si dhe, me të gjitha dokumentet e përpunuara nga shoqëria (bilanci, libra llogarie).

-Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato me shkrim.

-Të heqë dorë nga shoqëria në kushtet që përcaktohen në aktet e shoqërisë.

NENI 12

Ortaku ka këto detyra kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij ose kuotën suplementare në përputhje me Aktin e Themelimit.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga ai vetë.
- Të kryejë detyrimet e ngarkuara për realizimin e detyrave të shoqërisë.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQËRISË

NENI 13

Organi më i lartë vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve e përbërë nga ortaku i vetëm.

Asambleja e Ortakëve vendos për këto probleme:

- Miraton bilancin vjetor të shoqërisë.
- Vendos për shtimin, pakësimin ose transferimin e kapitalit themelor
- Eméron dhe shkarkon administratorin e shoqërisë.
- Bën ndryshime dhe kontrollin e Statutit sipas ecurive të shoqërisë.
- Vendos për mbylljen e aktivitetit të shoqërisë ose për shndërrimin e saj.

Në rast të ekzistencës të më shumë se një ortaku, unanimiteti në vendimet e Asamblesë është i domosdoshëm për çështjet që vijojnë:

- Për modifikimin e kontratës dhe të statutit.
- Për rrithjen, pakësimin ose transferimin e kapitalit themeltar dhe për mbylljen e shoqërisë.

Për çështje të tjera, Asambleja vendos me shumicë votash.

Asambleja e Ortakëve thirret jo më pak se një herë në vit.

NENI 14

Administratori i shoqërisë ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë në marrëdhëniet me personat e tretë.

Administratori, nuk mund të kryejë ato detyra që i janë lenë për kompetencë Asamblesë së Ortakëve.

Shoqëria merr përsipër të gjitha pasojat që mund të vijnë nga veprimet e administratorit.

NENI 15

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj personave të tretë, kur gjatë veprimeve të tij shkel ligjin, kontratën dhe statutin ose, për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 16

Marrëdhëniet e punës me punëtorët që do të punësohen pranë shoqërisë "Elka S.A" SH.P.K, irregullohen me kontrata individuale që do të lidhen me secilin prej tyre.

KREU V

MBYLLJA E AKTIVITETIT TË SHOQËRISË

NENI 17

Veprimitaria e shoqërisë pushon kur ortakët (ortaku), me vullnëtin e tyre të lirë, e vendosin këtë unanimisht.

Veprimitaria e shoqërisë pushon edhe në ato raste kur ortakët (ortaku) vendosin shndërrimin e shoqërisë nga Sh.P.K, në një lloj tjetër shoqërie.

NENI 18

Kur shoqëria likuidohet plotësisht, Asambleja krijon Komisionin e likuidimit, i cili paraqet bilancin e likuidimit.

Pasi shlyhen të gjitha detyrimet e shoqërisë, pasuria e shoqërisë, iu ndahet ortakëve në përpjestim me kontributin e tyre në kapitalin themeltar.

Pasuria që është futur në shoqëri me të drejtë shfrytëzimi, i kthehet pronarit të saj.

|Ortaku i vetëm**LEFTER KALLO**